



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

”Blerje fletë votimi për zgjedhjen e Autoriteteve dhe Organeve Drejtuese në UMT”:

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44174000-0/ 22821000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi Limit: në vlerën prej **2,403,310.40 (Dy milion e katërqind e tre mijë e treqind e dhjetë pik dyzetë) lekë pa T.V.SH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANËS** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Formulari i ofertës dhe çmimit, sipas shtojcës 1 dhe 2.*
- Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojce është pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen është e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe në këto rregulla.”

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ne te cilen është e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % i vlerës së përlllogaritur të kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejmë te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar... ”. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, duke gjykuar të arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet ekonomike dhe financiare të OE. Në këtë mënyrë AK krijon bindjen e përgjithshme për aftësinë e OE për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë*

dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron. Duke qenë një kontratë e rëndësishme për prodhimin me elementë sigurime e fletëve të votimit për zgjedhjet e autoriteteve dhe Organeve drejtuese në UMT, kërkohet vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % i vlerës së përllogaritur të kësaj kontrate (*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”.

(*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet na AK në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila nuk është me e madhe se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës. Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjykuar te arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE. Përcaktimi i vlerës së sipërcituar për furnizimet e mëparshme të ngjashme është një kriter i thjeshtësuar pranimit nga AK me qëllim nxitjen e pjesmarrjes dhe të Operatorëve të rinj në treg. Në këtë mënyrë AK krjon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se 15 % e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme për prodhimin me elementë sigurime e fletëve të votimit për zgjedhjet e autoriteteve dhe organeve drejtuese të UMT-së, kërkohet jo më të vogël se 15 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 15 % e vlerës së fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është përcaktuar se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Disenjator.
- 1 (një) Offset-ist.

Disponimi i punonjësve do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentet që duhet të paraqiten nga operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit janë:

- Kontratë pune të vlefshme;

- *Çertifikata në fushën e kërkuar, referuar objektit të prokurimit, të lëshuar nga institucione të liçensuara në R.Sh ose ekuivalent;*
- *Listëpagesa e muajit të fundit.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërmat b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme, stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, Konkretisht:

Gjykojmë se është e domosdoshme që mbështetur në preventiv dhe specifikimet teknike, operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të mjaftueshëm të specializuar/të kualifikuar si Disenjator dhe Offset-ist, që do të përfshihen dhe do të jenë të gatshëm në çdo kohë të zbatimit të kontratës për prodhimin dhe furnizimin mallrave të kërkuar. Nëpërmjet kësaj kërkesë AK sigurohet se OE ofertues disponon stafin përkatës së kualifikuar dhe me një eksperiencë minimale prej 1 muaji pranë tij, si dhe e argumentojmë me faktin se procesi i prodhimit kalon në disa faza, për printimin e rreth 23,720 fletë votimi, për të cilat OE duhet të jetë disponibël me stafin dhe makineritë e veta për gjatë gjithë kohës së kontratës.

Nga këta kërkohet disponimi i një disenjatori është i domosdoshëm për disenjimin e formatit dhe organizimin e elementeve përbërës të fletëve të votimit, që ka njohuri në fushën e dizajnit, i pajisur me certifikatë në fushën e dizajnit referuar objektit të prokurimit (disa programe si psh: Photoshop, Illustrator, Indisajn dhe Grafik-Disajn), të lëshuar nga institucione të liçensuara në R.Sh ose ekuivalent.

Ndërsa përcaktimi i kërkesës për offset-ist është i domosdoshëm për mbarëvajtjen e prodhimit dhe ndjekjen e procedurave të elementëve të sigurisë dhe prodhimit, i pajisur me certifikatë në fushën e offset-istit referuar objektit të prokurimit, të lëshuar nga institucione të liçensuara në R.Sh ose ekuivalent.

Nevoja e tyre vjen pasi prodhimi i fletëve të votimit nuk mund të bëhet në çdo lloj programi kompjuterik (si Word, Excel, një njihet nga kushdo), por bëhet në programe të posaçme dizajni, si rezultat duhet të bëhet nga punonjës që i njohin këto programe, dinë si të punojnë me to dhe kanë një eksperiencë pune.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i pajisjet	Sasi/ Njësi
1	UV Ploter, me fushë printimi minimum 50x70 cm	1 copë
2	Makinë shtypi 4 –ngjyrëshe, me format jo më pak se 50x70cm.	1 copë
3	Makine zhvillimi lastrash CTP, me format jo më pak se 70x100 cm	1 copë
4	Makineri për Performime	1 copë
5	Makineri numratorë me minimalisht 6 shifra	1 copë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara më sipër, të cilët duhet të disponojnë dokumentacionin si më poshtë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit janë:

- a) *Për pajisjet, që janë në pronësi, të disponohet fatura tatimore e shitblerjes/ akti i zhdoganimit/kontratat e dhurimit apo të blerjes së tyre/ pasqyrimin në balance ose çdo lloji forme të fitimit të pronësisë sipas parashikimit në ligj, Kodin civil të Republikës së Shqipërisë, me kusht që të provohet me dokumentacion të rregullt nga ana e operatorëve ekonomikë.*
- b) *Për pajisjet, që janë me qera, të disponohet kontrata e qirasë me afat sa realizimi i kësaj kontrate dhe fatura tatimore e shitblerjes/akti i zhdoganimit/kontratat e dhurimit apo të blerjes së tyre/ pasqyrimin në balance ose ose çdo lloji forme të fitimit të pronësisë sipas parashikimit në ligj, Kodin civil të Republikës së Shqipërisë, me kusht që të provohet me dokumentacion të rregullt nga ana e operatorëve ekonomikë.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” **i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”** dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur dhe ekzekutimin me sukses të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim për të provuar kapacitetet teknike të OE të cilët do të angazhohen në plotësimin e kushteve të kontratës në afatin e kërkuar, sipas preventivit (sasisë) dhe specifikimeve teknike lidhur me kryerjen e proceseve mbi formatin dhe elementët e sigurisë të fletëve të votimit. Të gjitha pajisjet e kërkuara janë në përputhje dhe të domosdoshme për këtë objekt prokurimi, për të garantuar AK dhe realizuar në kohë e me sukses kontratën nga OE, duke qenë disponibël me makineritë e nevojshme përgjatë gjithë kohës së kontratës, me faktin se procesi i prodhimit kalon në disa faza, për printimin e rreth 23,720 fletë votimi. Prandaj, janë kërkuar me këto parametra për efekt shpejtësie dhe realizim kontrate për 3 ditë, ku secila makineri ka rëndësinë e vet në procesin e prodhimit, pasi:

- *UV Ploter, fushe printimi minimumi 50x70 cm, shërben për të realizuar elementët e vecantë, si bojën e padukshme që shfaqet vetëm me llampën UV dhe elementët e sigurisë të nevojshme të fletëve të votimit, pasi çdo fletë kalon në proces llakimi që mos të fshihen elementeët e sigurisë.*
- *Makinë shtypi 4 –ngjyrëshe, me format jo më pak se 50x70cm, shërben për të realizuar procesin e kombinimit të ngjyrave dhe shtypit të elementeve bazë të fletëve të votimit: sfondin, kornizën, tekstin etj. me përmasat e kërkuara.*
- *Makinë zhvillimi lastrash CTP, me format jo më pak se 70x100 cm, shërben për të realizuar procesin e zhvillimit të lastrave nga OE, pasi krijohen lastra specifike për çdo prodhim të ri.*
- *Makineri për performime shërben për performimin e fletës në mënyrë që të bëhet shkëputja për tia dhën fletën votuesit*
- *Makineri numratorë me minimalisht 6 shifra shërben për vendosjen e numrave serialë të cilët janë të domosdoshme në vendosjen e fletëve pasi numrat serialë lidhin fletët me njëra tjetrën në momentin që fleta shkëputet për tia dhënë votuesit. Numri serial vendoset për çështje sigurie në mënyrë që mos të bëhet falsifikimi i asnjë flete.*

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëklarim që:

- merr përsipër furnizimin dhe transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK se OE do të ekzekutojë me sukses të kontratës.

Deklarata është kërkuar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të garantojë kryerjen e transportit deri në destinacion, në adresën e AK.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, sipas nenit 26, pika 7 të VKM për MRRPP.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të përkthyer dhe të noterizuara, nëse janë në gjuhë të huaj.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste

përrjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Specifikimet teknike janë vendosur sipas kërkesës kërkesës me Nr.6/23., Prot datë 21.05.2024, me lëndë “Përcillen numrat e votuesve personel akademik.....” dhe vendimit me nr.11 prot ., me datë 16.05.2024 nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ).

Objekti i kësaj kontrate është prodhimi dhe shtypshkrimi për procesin zgjedhor, ku duhet të shtypen 7(shtatë) modelet e fletëve të votimit me të dhënat e mëposhtme:

Fletë votimi për personelin Akademik:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Fletë votimi për Rektor me ngjyrë të verdhë	Copë	278
2	Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore me ngjyrë mente	Copë	278
3	Fletë votimi për drejtues të njësisë bazë me ngjyrë bojëqielli	Copë	278
4	Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik me ngjyrë lejla.	Copë	278

Fletë votimi për studentët:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Fletë votimi për Rektor me ngjyrë bezhë	Copë	7536
2	Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore me ngjyrë rozë.	Copë	7536
3	Fletë votimi për anëtarë të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve me ngjyrë gri	Copë	7536

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. Përcaktimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit në zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë vijon:

A. Elementë të konceptimit dhe prodhimit:

- Letër offset 80 gr.
- Shtyp me kombinim ngjyrash.
- Formati 335 mm x 230 mm.
- Orientimi i fletës së votimit qëndron në pozicionin vertikal.
- Karakteret e tekstit në fletën e votimit janë të tipit "vodafon".
- Në anësore të kokës së tekstit qëndron logo e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- Në fund të fletës qëndrojnë në një rresht 3 logo më të vogla të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, vetëm për efekt dizenjimi.
- Fletët e votimit do të prodhohen në blloqe jo më shumë se 100 fletë.

B. Elementë të sigurisë:

- Sfondi në të dy anët e fletës do jetë i dizenuar me elemente optikë shoqëruar me dy shirita 5-6 mm anash vertikalisht me ngjyrën e plotë të sfondit.
- Bojë e padukshme që shfaqet vetëm me llampë UV (ultravioletë), tek 1/2 e shqiponjës në logon e njësisë kryesore, lartë majtas, si dhe shkrimi “UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË” në harkun e poshtëm në këtë logo.
- Bojë e padukshme tek 3 logot e UMT-së më të vogla të vendosura poshtë fletës (foot), përkatësisht tek shqiponja dhe shkrimi “UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË” në harkun e poshtëm në këto logo.
- Numër serial unik vendoset në fund të fletës, në mes, mbi foot-note dhe shkëlqen kur vendoset llampa UV, i cili përmban akronimin e UMT, akronimin e njësisë kryesore si dhe numrin përkatës të llojit të fletës së votimit. Detajet të përcaktohen përpara prodhimit të fletëve të votimit.

2. Personeli akademik do të votojë me 4 (katër) fletë votimi si më poshtë:

- Fletë votimi për Rektor me ngjyrë të verdhë.
- Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore me ngjyrë mente.
- Fletë votimi për drejtues të njësisë bazë me ngjyrë bojëqielli.
- Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik me ngjyrë lejla.

3. Studentët do të votojnë me 3 (tre) fletë votimi si më poshtë:

- Fletë votimi për Rektor me ngjyrë bezhë.
- Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore me ngjyrë rozë.
- Fletë votimi për anëtarë të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve me ngjyrë gri.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas preventivit të mëposhtëm

Fletë votimi për personelin Akademik:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Fletë votimi për Rektor me ngjyrë të verdhë	Copë	278
2	Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore me ngjyrë mente	Copë	278
3	Fletë votimi për drejtues të njësisë bazë me ngjyrë bojëqielli	Copë	278
4	Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik me ngjyrë lejla.	Copë	278

Fletë votimi për studentët:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Fletë votimi për Rektor me ngjyrë bezhë	Copë	7536

2	Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore me ngjyrë rozë.	Copë	7536
3	Fletë votimi për anëtarë të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve me ngjyrë gri	Copë	7536

- Malli do të dorëzohet në Unviversitetin e Mjekësisë, Tiranë
- Grafiku i ekzekutimit të kontratës do të jetë: **3 ditë.**
- **Data e zgjedhjeve do të jetë në 21 Qershor**

Shënim: Vendosija e emrave të kandidatëve për zgjedhje në fletët e votimit do të bëhet në bashkpunim me Autoritetin Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës me Operatorin ekonomik fitues.

NJËSIA E PROKURIMIT: